



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/03/24
Datë: 25.03.2024 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESE

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e tretë (03) - e rregullt 2024 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 29.03.2024, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara; *vij 2023*
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara; *vih 2024*
5. Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave Komunale;
6. Inicimi i procedurës për hartimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marëdhënie me Publikun;
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
8. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	6-155/2212
DATË:	12.03.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THRU OUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/ËD/FROM:	z. Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUB JECT:	Përgjigje

I nderuar,

Pas shqyrtimit të kërkesës numër 6-155/2212 datë 11.03.2024, Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis jep këtë:

Përgjigje

Komuna e Junikut nxjerrë listën e veçantë të pronave Komunale që planifikohen të ipen në shfrytëzim, lista e njëjtë është miratuar nga Kuvendi i Komunës me datë 30.11.2023. Edhe pse është shpallë lista e veçantë e pronave Komunale që do të ipen në shfrytëzim, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis nuk ka pranuar asnjë kërkesë për marrjen në shfrytëzim të këtyre pronave.

Bashkangjitur gjeni Listën e Veçantë të Pronave Komunale që do të ipen në shfrytëzim.

Me respekt!

Lista e veçantë e pronave Komunale që planifikohen të ipen në shfrytëzim

Nr.	Certifikata nr.	Ngast a	Titullari	Sipërfaqja - m ²	Kultura-Klasa	Vendi i quajtur
1	116	704	Komuna e Junikut	56579	Mal-4	Vreshtat- Rogopeq
2	//	793	//	17089	Kullosë-4	Bajraktar-Rogopeq
3	//	804	//	51249	Mal-4	Vreshta -Rogopeq
	//	5032	//	13817	Mal -3	Qesta e Qokut
	//	5035	//	69770	Mal-2	//
4	//	1174	//	7633	Jo pjellore	Bajraktar-Varrezat e Imeraj
5	//	5183		1080	Tokë ndërtimore- Oborr	Hoxhë
6	//	3973	//	13072	Kullosë-3	Kloshe -Qesta e Gojanit
7	//	3975	//	1527	Mal-3	//
8	//	4042	//	1099	Livadh-3	Lluga e Bcgut-Bramatok
9	//	4064	//	618	Kullosë-2	//
	115	1036-1	//	8616	Kullosë -3	Pepsh-Vreshta e Pepshit
	//	1036-2	//	548	Rrugë	//

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK-OPSTIANA JUNIK-MUNICIPALITY OF JUNIK

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Lloji i punës: Plan Pune

**“PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA
TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2024”**

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

Komiteti Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara është formuar me Vendim të Kuvendit Komunal të Junikut me Nr. **002/01/23**. Ky komitet për vitin 2024 parasheh këtë plan të punës.

Komiteti Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara është organ këshill dhënës i Kuvendit Komunal i cili funksionin e vet e ushtron duke u bazuar në:

Ligjin për Vetëqeverisje Lokale 03L/40 dhe neni 4, paragrafi 1,2,3,4 dhe 5 të udhëzimit administrative (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e Themelimit Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, **neni 56 të Statutit të Komunës**. Kuvendi i Komunës së Juniut në mbledhjen e vet të mbajtur me dt: 27.01.2023, mori vendim për themlimin e Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuar.

E dimë se kujdesi për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Junikut është i organizuar nëpërmjet rrjetit të OJQ-ve (Handikos) si dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe MQS dhe QPS.

DSHMS dhe QPS në bashkëpunim të plotë ofrojnë shërbimet e përkujdesjes sociale për popullatën e komunës.

Gjate vitit do te mbahen 6 gjashtë Seanca të Rregullta, në të cilat do të shqyrtohen tematika që kanë të bëjnë me situatën dhe problematikën e personave me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Junikut , tre në 6 mujorin e parë dhe tre në gjashtë mujorin e dytë.

Gjatë përpilimit të Planit të Punës anëtarët e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara vendosën që gjatë vitit 2024 të punojnë si vijon:

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

FUSHA - SHËNDETËSI

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Krijimi i datbazës për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2024;2. Njoftimi i të gjithë akterëve në lidhje aktivitetet dhe vazhdimin e punës te Komitetit Konsultativ për persona me Aftësi të Kufizuara, (OJQ-të, drejtoritë komunale, organet e rendit, shkollat,e institucione tjera relevante).3. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara, manifestohet nga Komiteti me rastin e 3 dhjetorit, në të cilin eviniment ftohen të marrin pjesë antarët . e të gjitha llojeve të aftësisë së kufizuar në nivel lokal
-------------	--

FUSHA - ARSIM

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Identifikimi i numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mosha me qëllim të sistemimit në arsimin e rregullt,2. Bashkëpunimi i vazhdueshem me psikologen në shkollën e mesme të ulët “Edmond Hoxha” dhe mundësisht edhe një person për interpretimin e gjuhës së shenjave3. Krijimi i qasjes dhe kushteve të përshtatshme në objektin e shkollës4. Propozimi i shënimit të ditëve ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar
-------------	---

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

FUSHA – MIRËQENIE SOCIALE

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Identifikimi i NR të PAK, moshë, diagnoza;2. Klasifikimi i PAK sipas aftësisë së kufizuar;3. Rishikimi i numrit të PAK të punësuar;4. Të avokojm dhe bashkëpunojmë me kompanitë private për punësimin eventuale të personave me aftësi të kufizuara;5. Të avokojm që shërbimi i verifikimit të pensionistëve të bëhet në Junik6. Të shikohet mundësia e hapjes së një zyreje të Handikosit në Junik (informimi i pak, ofrimi i shërbimeve, etj., përmes broshurave, posterave, facebook, radio Ilirisë, etj.)
-------------	---

FUSHA - INFRASTRUKTURA

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Krijimi i qasjes në trotuare në Qendër të Junikut2. Krijimi i qasjes në objektet publike (komunë, QKMF, shkolla);3. Takimi i perbashket i Komitetit me kryetarin rreth perparimit të listës së subvencionimit të personave me aftësi të kufizuara në komunën tonë.
-------------	---

AKTIVITETE TJERA:

Shiqimi i mundësisë për realizimin e trajnimeve për avancim të njohurive të anëtarëve të komiteteve konsultative sa i përket ligjeve, rregulloreve që mund të realizohen përmes ndihmës së OSCE, Handikos dhe organizata tjera.

Informimi

Komiteti, përveq se për punën dhe aktivitetet e veta i raporton me shkrim Kuvendit Komunal të Junikut në baza vjetore dhe përmes raportimit për një temë të veçantë mbi komunitetin e aftësisë së kufizuar, për transparencë dhe për informim të drejtë të palëve të interesit:

- **Komiteti, tërë punën dhe aktivitetet e veta i publikon në Faqen Zyrtare të Komunës së Junikut , si dhe**
- **Komiteti krijin marrëdhënie me mediet e shkruaradhe ato vizuele për përcjelljen e punës dhe aktivitetëve të tijë sa here që ti jepet munsia, po ashtu edhe për promovimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuaranë Komunën e Junikut duke reaguar gjithmonë aty ku ato të drejta nuk perfillen apo edhe cenohen.**

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

REZYMEJA E PROGRAMIT

Realizimi i këtij programi do të sigurojë që personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Junikut të kenë një adresë të caktuar në të cilën ti ngrisin çështjet me të cilat ata ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme. Kjo do të arrihet edhe përmes formësimit dhe fuqizimit të rolit të Komitetit, i cili përherë do të ketë target Personat me Aftësi të Kufizuara në tërë territorin e Komunës së Junikut dhe do të merret ekskluzivisht me problemet e tyre.

Themelimi dhe fuqizimi i një organi të këtillë, i cili ka për qëllim avancimin e pozitës së këtijë komuniteti, do të jetë një hap i madh përpara në përmirësimin e gjendjes së tyre në Komunën e Junikut.

Me realizimin e këtijë programi vë gjer tek ngritja e kapacitetit dhe efikasitetit të punës së Komitetit, në drejtim që anëtarët e tij të jenë më proaktiv në ngritjen e interesave të komunitetit të tyre.

Perfundimisht dhe pasi që Komiteti është entitet institucional dhe i një specifikat e secilit komitet të aftësisë së kufizuar dhe të tërë komunitetit të aftësisë së kufizuar, përmes këtijë programi, i cili do të nënshtrohet një shqyrtimi komunitar, do të mund të arrihet gjer tek unifikimim dhe thjeshtëzimi i kërkesave dhe nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Junikut dhe më gjerë.

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

Gjashtë mbledhjet per vitin 2024 do të mbahen me:

- | | | |
|-----------|----------------|-------------------|
| 1. | Mars | 11.03.2023 |
| 2. | Prill | 15.04.2023 |
| 3. | Qeshor | 17.06.2023 |
| 4. | Shtator | 16.09.2023 |
| 5. | Nëntor | 18.11.2023 |
| 6. | Dhjetor | 16.12.2023 |

Komiteti Konsultativ per Persona me Aftësi të Kufizuara

Kryesuesi i KKPKA

z. Beqë Knushi



REPubLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-02/24
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	29.02.2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dytë (02) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.02.2024, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e Komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit, më pas konstatoi se në mbledhje marin pjesë të 14 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Vjollca Qestaj DBF, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM.

Anëtarët prezent

- | | |
|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | <ol style="list-style-type: none"> 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
|---|---|

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Prokurimit për vitin 2024,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023,
5. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, dhe
6. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua me 12 vota për, 0 vota kundër, dhe 0 vota abstenim.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, ne këtë mbledhje mungojnë: z.Zenel Maloku (AAK), znj.Festina Maloku (AAK) dhe znj.Lirjeta Shehu (LDK), e cila pas pikës së dytë i bashkëngjitet mbledhjes dhe është prezentë në sallë.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar, prezent janë 12 anëtar të e kuvendit, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes Janar 2024 u miratua.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Prokurimit për vitin 2024,

Prezantim te këtij raporti nuk pati, mirëpo për t'ju përgjigjur pyetjeve prezent ishte zyrtarja e prokurimit, znj.Florinda Maloku.

z.Leonard Lolluni, përshëndetje për të gjithë, pyetje, ne faqen e dytë, furnizim me pajisje harduerik (te forta) për kompjuter, për çka bëhet fjalë dhe po ashtu e pashë se keni kontraktuar nje kompani për te berë nje web-faqe, a mundemi me ditë se cila është ajo web-faqe?

z.Zenun Shala, përshëndetje për te gjithë, unë po përgjigjem, për pajisjet harduerike për kompjuter sepse ka te bejë me drejtorinë e urbanizimit, kjo është për arsye se kjo drejtori i ka pasur kompjuterët e vjetër, dhe ne kemi berë një kërkesë qe ti pajisim kompjuterët me pjesë me fuqi më të mëdha te punës dhe për këtë projekt janë ndarë shuma prej 7434€.

znj.Florinda Maloku, përshëndetje për te gjithë, sa i përket web-faqes, ne këtë pjesë është ende duke u punuar, dhe akoma kontrata nuk ka përfunduar.

znj.Leonora Shehu, përshëndetje për te gjithë, kjo web-faqe ka te bejë me promovimin e turizmit ne komunën e Junikut dhe ende nuk është funksionalizuar kjo web-faqe.

z.Leonard Lllolluni, cila drejtori është bartëse e këtij projekti.

znj.Vjollca Qestaj, përshëndetje për te gjithë, bartëse e këtij projekti është drejtorja pe zhvillim ekonomik.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për te gjithë, ne fokusin e zhvillimit te punëve që kemi përpos zhvillimit lokal kemi edhe zhvillimin e turizmit, dhe me ketë kemi menduar qe të kemi një web-faqe qe promovon turizmin ne komunën tonë, kjo është kontratë që akoma nuk është implemetuar.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023,

prezantim të këtij raporti nuk pati, po për ndonjë pyetje nga anëtarët e e kuvendit, për tu përgjigjur prezent ne kuvendi ishte kryesuesja e këtij komiteti.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, unë e qes ne votim raportin e punës se Komitetit për komunitete për vitin 2023, prezent ne sallë janë 13 anëtarë të kuvendit, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se raporti i punës se komitetit për komunitete për vitin 2023 u miratua.

5. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,

z.Leonard Lllolluni, pyetja ime ka te bëjmë me mirëmbajtjen e rrugës Junik-Bjeshkë(Gjeravicë), meqë u tha se prioritet është edhe turizmi ne komunën tonë, mirëpo puna ne teren është shumë e dobët, me rënien e parë të borës, drejtori i shërbimeve publike bënte disa filma se po i pastron rrugën për në bjeshkë me një traktor, ndërsa tani kemi rënieje te gurëve dhe kjo rrugë nuk është ka mirëmbahet, pyetja ime është se pse nuk është ka mirëmbahet kjo rrugë?

z.Ruzhdi Shehu, pajtohem me ketë, sepse gjatë dimrit ne i kemi dhënë qasje në atë pjesë sepse ka pasur shumë vizitorë vendas, por edhe të huaj që kanë vizituar bjeshkët tona, tani jemi të përgatitur edhe për ketë sezonë dhe vetëm i kemi dhënë urdhër kompanisë që të shkoj dhe të bejë mirëmbajtjen e kësaj rruge, për shkak të reshjeve ka pasur rrëshqitje, pra është obligim i kompanisë që të mirëmbajë këtë rrugë.

6. Të ndryshme.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për të gjithë, çështja ka te bëjë me rrugën “Qendër-lagje Pepsh” që kalon afër shkollës filllore, kjo rrugë është berë për marre, duhet te ngasësh veturën vetëm 10ore, sepse anash janë krijuar disa pengesa qe nuk mundesh me ngas makinën kur te ka parakalim te makinave tjera, do ishte mirë qe te ndërmerri diçka për ketë çështje, tjetër çështje është, kur u votua buxheti i këtij viti unë kisha tri kërkesa, njëra ka qenë rruga fushore në lagjen “Bajraktar”, ju na keni thënë se do te mereni me ketë rrugë dhe ne po shohim se ende nuk ka filluar asgjë ne këtë rrugë, kërkesa tjetër ka qene për kanal in e ujitjes afër kopshti te z,Sadat

Bajraktari, edhe për këtë projekt keni thënë se nëse teprojnë metra që keni fituar nga Ministria e Bujqësisë do të ndërmerri që ato metra të vinë aty për ndërtimin e këtij kanali të ujitjes por edhe kjo deri me tani nuk ka ndodhë, dhe kërkesa tjetër ka të bëjë me vendosjen e pengesave që mundëson ngadalësimin e shpejtësisë në lagjen “bajraktar”, kjo kërkesë është shumë here e shtruar këtu në këtë kuvend dhe ende nuk është ndërmarr asgjë që kjo të bëhet, ju e dini se në atë rrugë shpejtësia e automjeteve është duke u tejkaluar në përputhje që është shpejtësia e lejuar në atë pjesë, andaj konsideroj që është mëse e nevojshme vendosja e këtyre pengesave për derisa nuk kemi një humbje të jetës. Kërkesë është edhe nga banorët e lagjes, në të kundërtën këta banorë do të detyrohen të vendosin vet këto pengesa.

z.Ruzhdi Shehu, është e vërtetë që është diskutuar edhe me herët kjo çështje, tani pengesa do të ketë në atë rrugë, edhe për atë rrugën fushore do të fillojmë të punojmë por edhe për kanalin e ujitjes do të ketë shumë shpejt, deri tani nuk kemi mundur të fillojmë këto punë për shkatë të sezonës së dimrit, fillimi i vitit dhe këto çështje janë në agjendën e punëve tona dhe do të kryhen.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, çështja ka të bëjë me shtratin e lumit “Erenik”, meqë këtu e kemi drejtorin z.zenun Shala dhe besoj se mundet të na përgjigjet, drejtor e kemi diskutuar shumë here këtë çështje, siç e dini shtrati i lumit Erenik” është në shkatrim e sipër, dhe qeveria e vendit ka bërë thirrje publike në ato komuna që ka patur vërshime do të subvencionon, dhe mua më intereson a keni bërë projekt për renovimin e shtratit të lumit Erenik, dhe a e keni pasur të arsyeshme që qeverisja e kaluar në komune tona që ta bëni një shkresë dhe ta depononi në prokurinë e shtetit për degradimin e shtratit të lumit Erenik.

z.Zenun Shala, ne e kemi kontaktuar një firmë për projekte, pikat gjeodezike i ka marrë dhe pritjet që shumë shpejt ta kemi projektin final për shtratin e lumit Erenik, me këtë projekt do të aplikojmë në ministrinë e infrastrukturës, sektori i ujërave, ky sektor vitin e kaluar nuk ka pasur fonde, këtë vit ka fonde, kështu që besojmë se do të bëjmë me të mirën që shtrati i lumit Erenik të jetë i rregulluar ashtu siç i ka hije.

z.Dervish Bajraktari, çështja ka të bëjë me shëndetësinë, para një jave i pata disa familjar me grip, dhe i dërgova në QKMF dhe aty hasem mungesë të barnave, një infuzion nuk u gjet, këtu në këtë sallë keni deklaruar se keni buxhet të mjaftueshëm a këtu kemi mungesë të barnave, për mua kjo është e pa kuptuar.

z.Fatos Shala, përshëndetje për të gjithë, në fakt buxhet të mjaftueshëm nuk kemi thënë, por kemi thënë se furnizim kemi bërë dhe kontrata ka qenë afërsisht 12000€, mjaftueshëm kemi qarë infuzione por mund të ketë qenë

koha kur ka pasur vonesa te prurjes se barnave ne QKMF, ju e dini se ne ketë sezonë kemi pasur një grip ku fluksi i pacientëve ka qenë i lartë dhe ndoshta kjo ka ndikuar edhe te kete mungesa te infuzioneve, ju mire e keni, se ne duhet te planifikojmë me shumë dhe deri me tani furnizimi nga lista esanciale e nivelit qendrorë ka qenë deri ne 40% te kësaj liste.

z.Lulzim Gacaferi, nuk mu përgjigjet për çështjen e dërgimit te dokumentacionit te shtratit të lumit Erenik ne prokurim qe prokuria e shteti te meret me këta abuzues te paras publike.

z.Zenun Shala, sa i përket ndërtimit te shtratit te lumit Erenik me sa e di prokuria e shtetit është duke u marë me ketë çështje dhe deri ku ka arritur kjo nuk mundem ta di, keni te drejtë me atë qe e thoni projekti i me parshëm nuk është zbatuar tërësisht.

z.Ruzhdi Shehu, shqetësim me vend, ne si komune jemi të gatshëm te bashkëpunojmë me të gjitha institucionet relevante për ketë çështje dokumentet qe na u kanë kërkuar ju kemi dhënë dhe tash është prokuria duke u mare me ketë çështje dhe deri ne cilën fazë ka arritur ne nuk dimë.

z.Leunard Lllolluni, meqë u përmend prokuria dhe cilësia e ndërtimit te projekteve, do ishte mirë qe prokuria edhe me ndërtimin e rrugës Junik-Bjeshkë, qe është ndërtuar vitin e kaluar, dhe është shkatërruar pa u bë një vit.

z.Ruzhdi Shehu, plotësisht ke të drejtë, unë nuk jam ekspert për te vlerësuar rrugët malore, problemet qe janë gjatë trasave neper bjeshkë për te gjitha çështjet jam i gatshëm me dhënë mbështetjen dhe bashkëpunimin sa i përket shpenzimit të parasë publike.

z.Dervish Bajraktari, sa i përket shtratit te lumit Erenik, ne e dimë se ne vitin 2013 është ndërtuar ky shtrat dhe te gjithë kemi qenë te krenuar me ketë projekt dhe tani jemi ne vitin 2024 dhe keni dy vite e gjysmë qe qeverisni dhe ende merni me te kaluarën dhe nuk i shikoni projekte qe ju doni me i ber dhe nuk po i bëni. Ju nuk jeni ardhur te mëreni me te kaluarën por ta bëni më mirë, ok. për ata që kanë berë shkelje po por jo pas dy viteve e gjysmë.

z.Lulzim Gacaferi, është e vërtet qe shtrati i lumit Erenik ka filluar te ndërtohet ne vitin 2013, por para tri viteve ka qenë ndërtimi i fazës se fundit andaj nuk duhet te thuhet që mos te mëremi me ketë çështje sepse këtu ka abuzim te parasë publike, po ashtu edhe ndërtimi i rrugës për ne bjeshkë është duke u ndërtuar pa asnjë koncept te punës nga ana e kompanisë dhe për ketë arsye kemi dëmtim te rrugës qe është e ndërtuar vitin e kaluar ndërsa ketë vit është e dëmtuar, unë them qe komuna te ndërmarr te gjitha masat qe kjo rrugë te ndërtohet sipas projektit dhe aty ku shikohet se nuk është duke u ndërtuar sipas projektit të ndërpriten punët menjëherë, dhe te merren masat e duhura qe projekti te finalizohet ashtu siç edhe është projektuar. Po ashtu unë kam një kërkesë për kryetarin qe lidhet me njësinë e zjarrfikësve ne komunën e Junikut, e di se është njësi e pavarur por meqë është ne kuadër te komunës , komuna te beje kërkesë qe kjo njësi te pajiset me te gjitha pajisjet me staf, dhe te rregullohet oborri i këtij njësi, unë sot mora informatë se ne komunën tonë kemi vetëm dy zjarrfikës, dhe dua te di se a keni bërë kërkesë për pajisjen me te gjitha pajisjet për fikjen e zjarrit, por edhe me personel?

z.Leonard Lolluni, u potencuar me herët se prioritet është zhvillimi i turizmit ashtu është e parapare edhe me plani zhvillimor komunal, mire por kur e shohim ne teren qe nuk është ka aplikohet ne atë mënyrë, dhe e marrim si shembull drejtoria për zhvillim ekonomik për momentin është pa drejtor, zyrtari për bujqësi është pensionuar, dhe kur ta shtojmë kësaj edhe mungesën e kuadrove për zëvendësim te këtij vendi pune, dhe zyrtari tjetër qe është për zhvillim ekonomik kryen punë tjera ne drejtorinë për buxhet, zyrtari i pylltarisë edhe ai edhe dy vite del në pension dhe po i bie qe drejtoria për zhvillim ekonomik po mbyllet, dhe atëherë unë shqetësohem se ka jemi duke shkuar si komune, dhe unë jam pak sa lokalist dhe kur shikojmë komunat për rreth janë duke avancuar shume ne këtë çështje, deri sa ne kemi qene hapa te mire te zhvillimit te turizmit, duhet te aktivizohuni me shumë, nuk po e them këtë me te bë opozitë por vërtet mendoj se duhet te aktivizohuni me shume.

z.Ruzhdi Shehu, shume shpejt do te këtë plotësim te stafit dhe te drejtorisë, dhe sa i përket turizmit i kemi disa projekt me Natur Kosova qe janë duke u bere dhe disa projekte ne kuadër te IPAS te Bashkimir Euroian ne kuadër te zhvillimit te bash kufitar me komunën e Mirditës qe ekemi fituar dhe është ne kuadër te zhvillimit te turizmit dhe kur ta shtojmë edhe ndërtimin e rrugës për ne bjeshkë atëherë mendoj se nuk jemi duke e lenë anash zhvillimin e turizimit, po ashtu jemi ne biseda edhe me KEDS qe ta qojmë edhe energjinë elektrike ne atë pjese. Po ashtu dua ta ndaje një informatë me ju qe këto dite do te jam ne Mal te zi ku do te nënshkruhet një marrëveshje për bashkëpunim ndërkuftar qe benë pjesë edhe komuna e jone e qe është ne kuadër te zhvillimit te turizmit. Ndërsa sa i përket zjarrfikësve, qeveria është duke e përpiluar një vendi qe këto njësi te jene nën menaxhimin qendrorë apo të delegohen te komunat sepse për momentin me këtë ligj kemi dualizëm, pagat janë ne komuna a raportimi bëhet në qendër kështu është ne te gjitha komunat, ne kemi dërguar kërkesë për shtim të stafit disa here por nuk është lejuar deri sa të ndryshohet statusi i tyre.

z.Lulzim Gacaferi, unë e kuptoj se agjensioni i zjarrfikësve është i pavarur por çka është me e keqja se zjarrfikësit tanë nuk kanë leje për ngasjen automjeteve te rënda paramendoni qe një pjesëtar i kësaj njësie të shkaktojë aksident ku nuk ka leje për të vozitur atë automjet, andaj unë kërkojë që te bëni të pamundurën qe këta pjesëtar te pajisjen edhe me leje te lejuar qe ti ngasin këto automjete të rënda.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka , me kaq e shpalli të mbyllur mbledhjen e dytë të vitit2024.

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK-OPSTIANA JUNIK-MUNICIPALITY OF JUNIK

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji nr.03/L-040,GZRK nymër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statusit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numer 002/01 i datës 01.02.2019) dhe Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kryesuesi i Komitetit Konsultativ per persona me Aftesi te Kufizuar bënë këtë:

Raport:

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Lloji i punës: Raport Pune

Junik, shkurt 2024

“RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2023”

Komiteti Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara është formuar me Vendim të Kuvendit Komunal të Junikut me Nr. **002/01/23**.

Komiteti Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara është organ këshill dhënës i Kuvendit Komunal i cili funksionin e vet e ushtron duke u bazuar në:

Ligjin për Vetëqeverisje Lokale 03L/40 dhe neni 4, paragrafi 1,2,3,4 dhe 5 të udhëzimit administrative (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e Themelimit Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, **neni 56 të Statutit të Komunës**. Kuvendi i Komunës së Juniut në mbledhjen e vet të mbajtur me dt: 27.01.2023, mori vendim për themelimin e Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuar.

E dimë se kujdesi për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Junikut është i organizuar nëpërmjet rrjetit të OJQ-ve (Handikos) si dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe MQS dhe QPS.

DSHMS dhe QPS në bashkëpunim të plotë ofrojnë shërbimet e përkujdesjes sociale për popullatën e komunës.

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

Gjate vitit janë mbajtur 6 gjashtë Seanca të Rregullta, në të cilat takime janë shqyrtuar tematika që kanë të bëjnë me situatën dhe problematikën e personave me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Junikut , tre në 6 mujorin e parë dhe tre në gjashtë mujorin e dytë.

Kktivitetet që anëtarët e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara gjatë vitit 2023 kanë shtjelluar temat me sa vijon:

FUSHA - SHËNDETËSI

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Krijimi i datbazës për persona me aftësi të kufizuara;2. Njoftimi i të gjithë akterëve në lidhje me krijimin e Komitetit Konsultativ për persona me Aftësi të Kufizuara, (OJQ-të, drejtoritë komunale, organet e rendit, shkollat,e institucione tjera relevante).3. Krijimi i qasjes sa më të lehtë në objektin e QKMF-së dhe në objekte tjera publike;4. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara, manifestohet nga Komiteti me rastin e 3 dhjetorit, në të cilin eviniment ftohen të marrin pjesë antarët . e të gjitha llojeve të aftësisë së kufizuar në nivel lokal
-------------	--

FUSHA - ARSIM

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Identifikimi i numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mosha me qëllim të sistemimit në arsimin e rregullt,2. Avokojm që të kemi psikolog/asistent në shkollën e mesme të ulët “Edmond Hoxha” dhe mundësisht edhe një person për interpretimin e gjuhës së shenjave3. Krijimi i qasjes dhe kushteve të përshtatshme në objektin e shkollës4. Propozimi i shënimit të ditëve ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar
-------------	---

FUSHA – MIRËQENIE SOCIALE

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Identifikimi i NR të PAK, mosha, diagnoza2. Klasifikimi i PAK sipas aftësisë së kufizuar3. Rishikimi i numrit të PAK të punësuar4. Të avokojm dhe bashkëpunojmë me kompanitë private për punësimin eventuale të personave me aftësi të kufizuara5. Të avokojm që shërbimi i verifikimit të pensionistëve të bëhet në Junik6. Të shikohet mundësia e hapjes së një zyreje të Handikosit në Junik (informimi i pak, ofrimi i shërbimeve, etj., përmes broshurave, posterave, facebook, radio Ilirisë, etj.)
-------------	---

FUSHA - INFRASTRUKTURA

AKTIVITETET	<ol style="list-style-type: none">1. Krijimi i qasjes në trotuare në Qendër të Junikut2. Krijimi i qasjes në objektet publike (komunë, QKMF, shkolla)
-------------	--

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

AKTIVITETE TJERA:

Shiqimi i mundësisë për realizimin e trajnimeve për avancim të njohurive të anëtarëve të komiteteve konsultative sa i përket ligjeve, rregulloreve që mund të realizohen përmes ndihmës së OSCE, Handikos dhe organizata tjera.

Informimi

Komiteti, përveq se për punën dhe aktivitetet e veta i raporton me shkrim Kuvendit Komunal të Junikut në baza vjetore dhe përmes raportimit për një temë të veçantë mbi komunitetin e aftësisë së kufizuar, për transparencë dhe për informim të drejtë të palëve të interesit:

- **Komiteti, tërë punën dhe aktivitetet e veta i publikon në Faqen Zyrtare të Komunës së Junikut , si dhe**
- **Komiteti krijin marrëdhënie me mediet e shkruaradhe ato vizuele për përcjelljen e punës dhe aktiviteteve të tijë sa here që ti jepet munsia, po ashtu edhe për promovimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuaranë Komunën e Junikut duke reaguar gjithmonë aty ku ato të drejta nuk perfillen apo edhe cenohen.**

REZYMEJA E RAPORT-PROGRAMIT

Realizimi i këtij raport-programi do të sigurojë që personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Junikut të kenë një adresë të caktuar në të cilën ti ngrisin çështjet me të cilat ata ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme. Kjo do të arrihet edhe përmes formësimit dhe fuqizimit të rolit të Komitetit, i cili përherë do të ketë target Personat me Aftësi të Kufizuara në tërë territorin e Komunës së Junikut dhe do të merret ekskluzivisht me problemet e tyre.

Themelimi dhe fuqizimi i një organi të këtillë, i cili ka për qëllim avancimin e pozitës së këtijë komuniteti, do të jetë një hap i madh përpara në përmirësimin e gjendjes së tyre në Komunën e Junikut.

Me realizimin e këtijë raport-programi vie gjer tek ngritja e kapacitetit dhe efikasitetit të punës së Komitetit, në drejtim që anëtarët e tij të jenë më proaktiv në ngritjen e interesave të komunitetit të tyre.

Perfundimisht dhe pasi që Komiteti është entitet institucional dhe i një specifikat e secilit komitet të aftësisë së kufizuar dhe të tërë komunitetit të aftësisë së kufizuar, përmes këtijë programi, i cili do të nënshtrohet një shqyrtimi komunitar, do të mund të arrihet gjer tek unifikimim dhe thjeshtëzimi i kërkesave dhe nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Junikut dhe më gjerë.

Gjashtë mbledhjet për vitin 2023 janë mbajtur me:

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PAK

1.	Mars	09.03.2023
2.	Prill	14.04.2023
3.	Qeshor	16.06.2023
4.	Shtator	15.09.2023
5.	Nëntor	17.11.2023
6.	Dhjetor	15.12.2023

Kryesuesi i KKPAK

Beqë Knushi
